



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:001878
Datë: 20.05.2024
Numri i dokumentit: 05708272

C.nr.2022:081649

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në kontestin e paditëses Xh.R. nga fsh. ...-K.Ferizaj, me numër personal ..., që me autorizim e përfaqëson av. Zejnije Berisha nga Ferizaj, kundër të paditurve Komuna Ferizaj dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Ferizaj, rr. ..., për shkak të kompensimit të pagës jubilarë, pagës së 13-të, si dhe shujtave ditore, vlera e kontestit 2995€, pas mbajtjes së seancës përgatitore, me datën 20.05.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. Konsiderohet e tërhequr padia** e paditëses Xh.R. nga fsh. ...-K.Ferizaj, kundër të paditurve Komuna Ferizaj dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Ferizaj, për shkak të kompensimit të pagës jubilarë, pagës së 13-të, si dhe shujtave ditore, vlera e kontestit 2995€.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.**

A r s y e t i m

Paditësja, që me autorizim e përfaqëson av. Zejnije Berisha nga Ferizaj, pranë kësaj gjykate më dt. 08.01.2021 ka parashtruar padinë, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Ferizaj, rr. ..., për shkak të kompensimit të pagës jubilarë, pagës së 13-të, si dhe shujtave ditore, vlera e kontestit 2995€.

Gjykata Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin C.nr.22/21 të dt. 15.11.2021 është shpalluar inkompetent në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas padisë së paditëses dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi shkresat e kësaj lënde t'i dërgohen Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative si gjykatë me kompetencë lëndore në këtë çështje.

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin AC.nr.148/22 të dt. 07.02.2022 e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të autorizuarit të paditëses ndërsa aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.22/21 të dt. 15.11.2021 e ka vërtetuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative me aktvendimin A.nr.988/2022 të dt. 01.08.2023 ka hapur konfliktin për kompetencë në mes Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative dhe Gjykata Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni për çështje civile, për të vendosur në këtë çështje juridike në lidhje me kompetencën lëndore. Për të vendosur lidhur me konfliktin për kompetencë, lënda i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë-kolegjit për çështje administrative.

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin AN.nr.100/23 të dt. 29.08.2023, për gjykim në këtë çështje juridike është kompetente Gjykata Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë me kompetencë lëndore dhe territoriale, dhe shkresat e lëndës i dërgohen në veprim të mëtejme kësaj gjykate.

Me datën 15.04.2024, ora 13:15, gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit përgatitor, në të cilën nuk ka prezantuar përfaqësuesja e paditëses av. Zejnije Berisha nga Ferizaj, edhe pse në shkresat e lëndës ka pasur prova se e njëjta ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt sipas procesverbalit të seancës përgatitore të dt. 09.01.2024, ora 13:15, ndërsa që mungesën e saj nuk e ka arsyetuar dhe nuk ka propozuar shtyerjen e seancës. Pasi që përfaqësuesja e paditëses mungoi ndërsa mungesën e saj nuk e ka arsyetuar si dhe nuk ka propozuar shtyerje të seancës, në bazë të nenit 409.1 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Ndërsa secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta, konform nenit 450 të LPK dhe mbi këtë bazë u vendosë si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Nga të gjitha të lartcekurat, u vendosë si në dispozitiv të aktvendimit.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.2022:081649, me datë 20.05.2024

Gjyqtari,

Armend Ahmeti.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit, e nëpërmjet të kësaj gjykate.